

VENDIM
Nr. 66/2019

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017 “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Deputetët Artur Roshi dhe Krenar Rryçi caktohen anëtarë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

2. Deputetët Edmond Stojku dhe Ervis Meço caktohen anëtar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

3. Deputeti Selami Jenishehri caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.5.2019.